

## **Qasje në informacione, respektimi i rekomandimeve zyrtare dhe i kushteve të punës gjatë kohës së epidemisë së koronavirusit – rezultatet hulumtuese të projektit MigCOVID ndaj popullësisë me prejardhje emigrante**

Pranimi i informacioneve aktuale të besueshme dhe të mjaftueshme, është shumë me rëndësi gjatë situatave me kriza, sikurse kjo gjatë kohës së pandemisë globale të koronavirusit (Covid-19). Përveç sigurimit të qasjes në informacione, është me rëndësi t'i kushtohet vëmendje faktit që informata e rritë motivimin për respektimin e masave parandaluese. Disa nga grupet e popullsisë mund të jenë më të dëmtuara se grupet tjera në situata krize. Kjo mund të jetë për shkak të vështërsive në qasje të informatave apo për shkak të asaj që në këto grupe antarët e tyre janë më të ekspozuar ndaj infeksionit me koronavirusin sesa antarët në grupeve tjera për shkak të strukturës së tyre jetësore (kushtet e punës, kushtet e jetës, etj).

Qëllimi i punës së dokumentuar këtu është të vlerësoj qasjen në informacione, respektimin e masave parandaluese dhe kushteve të punës për popullsinë emigrante duke i përdorur të dhënat nga materjali hulumtues i realizuar nga Instituti kombëtar për shëndetësi dhe mirëqenje lidhur me ndikimet e Epidemisë së koronavirusit në mirëqenjen e personave (20-66 vjeç) me prejardhje emigrante (MigCOVID n= 3 668, niveli i pjesëmarrjes në hulumtim 60%). Si informacione referente përdoren të dhënat që mund të jenë të krahasueshme mes veti nga hulumtimi përcjellës FinTerveys 2017 për grupmoshat e njëjta nga e tërë popullsia (n=3490, përgjigjja e pjesëmarrësve në hulumtim 51 %), për atë që ka pasur mundësi të ketë qasje në këto të dhëna.

Shumica e qartë e personave nga popullsia emigrante (94 %) si dhe nga e tërë popullsia (98 %) kanë raportuar se kanë pasur qasje në informata të mjaftueshme për koronavirusin dhe për masat parandaluese ndaj infeksionit. Personat emigrant që kanë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës finlandeze dhe suedeze, kanë treguar se kanë pasur qasje në informata të mjaftueshme më shpesh (97 %) sesa ata që njohuria e gjuhës ishte e nivelit mesatar (92 %) apo më së shumti (91 %) për ata në nivelin fillestar të gjuhës. Pjesëmarrësit në hulumtim treguan se i kanë respektuar masat parandaluese kryesisht mirë, veçanrisht duke qëndruar në shtëpi me simptoma të gripit (nga popullsia emigrante 96 % dhe nga e tërë popullsia 97 %), kanë zbatuar në masë efektive higjienën e duarve dhe kanë zbatuar higjienën të mirë të kollitjes (93 % nga të dy grupet e popullsisë), si dhe kanë mbajtur distancë sigurie (nga popullsia emigrante 94 % dhe nga e tërë popullsia 95 %). Niveli i raportimit për përdorimin e maskave të fytyrës ka qenë më i ulët (nga popullsia emigrante 82 % dhe nga e tërë popullsia 84 %).

Prej rekomandimeve që më së paku u respektua, nga popullsia emigrante, ishte të shmangurit nga udhëtimet jashtë vendit (popullsia emigrante 84 % dhe nga e tërë popullsia 97 %) si dhe shkarkimi i aplikacionit Koronavilkku në telefon (popullsia emigrante 43 % dhe nga e tërë popullsia 63 %). Në këto dy gjëra u vrejten poashtu dallime të konsiderueshme mes grupeve të popullsisë emigrante të ardhur nga vende të ndryshme. Gratë i respektojnë rekomandimet më shpesh se burrat. Personat e ardhur në Finlandë (30 %) kanë raportuar në masë të konsiderueshme më pakë sesa e tërë popullsia (43 %) se puna nga distanca është shtuar si pasojë e epidemisë së koronavirusit. Rreth një e katërta e femrave me prejardhje emigrante që ishin në punë apo në ushtrimin e profesionit, kanë punuar në shërbimin shëndetësor, ku kishin takuar klientë. Pjesëmarrja e grave nga Afrika në krahasim me grupet tjera këtu ishte më e lartë (60 %). Pakë më shumë se gjysma (56 %) e të punësuarve apo në ushtrimin e profesionit nuk kanë arritur me e mbajtë distancën e sigurisë në punë. Për higjienën e mirë të duarve kanë pasur mundësi me u kujdesë 72 % e atyre që ishin të punësuar apo në ushtrimin të profesionit.

Përjetimi i situatës së qasjes në informata të mjaftueshme dhe në respektimin e masave parandaluese, nga ana e tyre, ishte pothuaj i mirë. Lidhja mes qasjes së mjaftueshme në informata dhe nivelit të njohjes së gjuhës finlandeze apo suedeze, e thekson si të nevojshme përdorimin e gjuhës së të folurit të qartë në kanalet informative. Informimet shumë gjuhësore dhe në shumë kanale janë të nevojshme në masë të veçantë atëherë kur rekomandimet përditësohen apo plotësohen gjatë kohës së epidemisë së koronavirusit. Është e mundur, që në përgjigjëjet e raportuara për respektimin e rekomandimeve të ketë në njëfarë mase edhe përgjigjëje të gabuara sikurse nga ana e popullsisë emigrante ashtu edhe nga e tërë popullsisë. Nëse faktorët që ndërlidhen me kushtet e punës e shtojnë rrezikun e infeksionit, dhe këta faktorë nuk mund të eliminohen plotësisht, punëdhënsi duhet t'i kushtoj më tepër vëmendje organizimit të punës në kushte më të volitshme, të bëjë kontrollin ndaj respektimit të këshillave dhe udhëzimeve duke zvogluar ekspozimet e panevojshme ndaj infeksionit me koronavirusin në vendet e punës.

**Fjalët kyçe:** koronavirusi (Covid-19), emigrimi nga vendet e jashtme, veprimet parandaluese të infeksionit